

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Наставна програма

АЛБАНСКИ ЈАЗИК (ИЗБОРЕН ПРЕДМЕТ)

за VIII одделение

Programi mësimor

GJUHË SHQIPE (LËNDË ME ZGJEDHJE)

për klasën VIII

Скопје, Shkup, 2025

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	Lëndë me zgjedhje
Klasa	VIII (e tetë)
Tema/fusha programore	• Unë dhe të tjerët - familja ime, shtëpia ime, miqtë e mi dhe mjedisi ku jetoj • Shkolla, vendbanimi, interesat dhe koha e lirë • Trupi ynë, shëndeti dhe të ushqyerit
Numri i orëve	2 orë në javë / 72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, dërrasë e zezë, teknologji kompjuterike, printer. • Mjetet dhe burimet mësimore: foto, fotografi, postera, postera nga libra, diagrame dhe ekspozita të materialit mësimor, tabela që përcjellin materialin mësimor sipas fushave; fjalorë, fjalorë drejtshkrimi, leksikon, enciklopedi, libra, programe edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; • Biblioteka me libra në klasë, biblioteka e shkollës.
Normativi për kuadrin mësimor	Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe (lëndë me zgjedhje) në klasën e VIII të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore: • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike.</i>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në Programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën
Përdorimi i gjuhëve të tjera

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
II-A.1	të kuptojë fjalitë dhe frazat që përdoren shpesh dhe që kanë të bëjnë me fusha të afërta me rëndësi personale (të tilla, si informacione personale dhe familjare, nevoja dhe interesa të ndryshme);
II-A.2	të nxjerrë porositë kryesore nga mesazhet e thjeshta e të qarta, nga njoftimet, nga udhëzimet nga lutjet etj.
II-A.3	të lexojë dhe të kuptojë tekste të thjeshta të llojeve të ndryshme, për tema të njohura dhe më pak të njohura, të përshtatshme për moshën;
II-A.4	të gjejë informacione konkrete në tekste reale të ndryshme (p.sh. në reklama, në plane, në udhëzime, në broshura, në lista ushqimesh, në orare udhëtues etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, për të menaxhuar situatat e përditshme.
II-A.5	të komunikojë në situata të përditshme konkrete kur kërkohet një shkëmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë informacioni për tema të njohura;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe intonacionit, ndërkohë që parregullsitë e mundshme të mos e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të përdorë shprehje të zakonshme dhe fjali që përdoren gjatë përvojës së drejtpërdrejtë dhe/ose u referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit;
II-A.9	të respektojë rregullat themelore të gramatikës në të shprehurit me shkrim dhe me gojë;
II-A.10	të shprehë dhe të argumentojë ndjenjat dhe mendimet në lidhje me çështjet me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.11	të përdorë varg deklaratash dhe fjalish për të shkruar një mesazh, një letër, një shënim, një kartolinë dhe të përshkruajë me fjalë të thjeshta gjërat me interes të drejtpërdrejtë;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
II-B.1	të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe mundësinë e komunikimit me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
II-B.2	njohja e më shumë gjuhëve lehtëson qasjen në burime që janë të dobishme për përvetësimin e lëndëve/përmbajtjeve të tjera mësimore;
II-B.3	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe respekti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme;
II-B.4	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet respekti për kulturat e tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të fushave të Standardeve nacionale, siç janë: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura.**

IV. Njohuri digjitale

<i>Nxënësi/nxënësjat di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe të krahasojë mundësitë e pajisjeve dixhitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë apo për një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe instalojë programe që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidhë probleme rutinë në funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve të ndryshme digjitale;
IV-A.3	të përdorin mënyra të ndryshme për të organizuar, për të ruajtur dhe për të ndarë në mënyrë të sigurt përmbajtjet në pajisje dhe rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plane për hulumtimin dhe për zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë të përdoret TIK-u;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë lidhjen e tyre me nevojën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, të analizojë të dhënat dhe t'i paraqesë ato në mënyra të ndryshme duke respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë dhe të përdorë mjetet e duhura të TIK-ut për komunikim, të ndajë në mënyrë të sigurt informacionin, të kontaktojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën digjitale multikulturore;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
IV-A.11	të planifikojë dhe zhvillojë pjesë udhëzimesh të qarta për kryerjen e një detyre specifike dhe t'i paraqesë ato si një algoritëm programimi;
IV-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitje statike dhe dinamike, zë, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta multimediale me një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret e cilësisë për produktet dhe zgjidhjet digjitale duke përfshirë inovacionin dhe dobinë prej tij.
<i>Nxënësi/nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;

IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe jo i duhur i TIK-ut ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose për shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut do të rriten prandaj duhet të ndiqen dhe përdoren duke pasur qasje kritike ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes dhe dhuna kibernetike dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;
IV-B.6	duhet të respektohen të drejtat e pronësisë intelektuale të produkteve të disponueshme në rrjetet digjitale;
IV-B.7	pozita jo e duhur e trupit dhe përdorimi i pamasë i teknologjive digjitale mund të ndikojë negativisht në shëndetin, jetën personale dhe sociale dhe ruajtja jopërkatese e hedhurinave digjitale ndikon në mënyrë të pavoritshme në mjedisin jetësor.

V. Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
V-A.1	të dallojë mënyrën e shëndetshme të jetesës nga ajo e rrezikshmja në të gjitha sferat e jetës (duke përfshirë zakonet e të ngrënit, aktivitetet sportive dhe rekreative dhe sjelljen seksuale);
V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij mendore dhe fizike;
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet i cili ndërtohet mbi bazën e përkatesisë ndaj identitetit të ndryshëm shoqëror (p.sh. gjinia, identiteti etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (p.sh. nxënësi, djali/vajza);
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatese për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimi e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe për të tjerët;

V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, me vetëdije të plotë se kujt, kur dhe si të kërkohet ndihmë.
V-A.12	të përballojë me sukses presionet sociale;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.16	të njohë problemet në marrëdhëniet me të tjerët dhe t'i qaset në mënyrë konstruktive zgjidhjes së konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, të bëjë pyetje përkatëse, për të zbuluar probleme, për të analizuar dhe vlerësuar informacionin dhe propozimet dhe për të kontrolluar supozimet;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.20	të analizojë në mënyrë kritike informacionin dhe dëshmitë sipas kriterëve përkatëse;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënit.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerr është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.5	zgjidhja e problemeve dhe konflikteve, varet nga mënyra se si i qaset zgjidhjes së problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve;
V-B.6	suksesi në jetë, në një masë të madhe, varet nga qëllimet që ai i vendos vetes , ndërsa efikasiteti dhe efektiviteti në arritjen e qëllimeve të vendosura në masë të madhe varet nga mënyra se si ai i planifikon aktivitetet dhe organizon kohën e tij;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;

V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
V-B.10	të mësuarit është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

VI. Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi /nxënësjë di dhe mund:</i>	
VI-A.1	të shpjegojë se si faktorët socialë ndikojnë në personalitetin e njeriut dhe në mjedisin jetësor dhe t'i marrin ato parasysh gjatë formimit të opinioneve dhe marrjes së vendimeve;
VI-A.2	të analizojë sjelljen e vet me qëllim të përmirësimit, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe të analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt edhe kur nuk është dakord me to;
VI-A.4	të reflektojë në mënyrë kritike për vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (veçanërisht në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranura nga shoqëria, por edhe t'i sfidojë ato kur mendon se është e nevojshme;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjyqimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël), në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
	të identifikojë dhe t'i rishqyrtojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që manifestohen në mjedisin e tij/saj;
VI-A.19	të shpjegojë rëndësinë e proceseve demokratike në shoqëri dhe të zbatojë parimet e pjesëmarrjes demokratike në kuadër të shkollës.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.)
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre.

VI-B.3	të drejtat e njeriut janë universale dhe kufijtë e të drejtave të çdo personi janë të drejtat dhe liritë e të tjerëve;
VI-B.4	respektimi pa dallim i të drejtave dhe lirive të njeriut është thelbësor për mirëqenien e individëve dhe shoqërisë në tërësi;
VI-B.5	barazia, e drejta dhe kohezioni social janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishëm për arritjen e interesit të përbashkët publik;
VI-B.7	çdo qytetar është i detyruar të sillet me përgjegjësi ndaj bashkëqytetarëve të tij, ndaj komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, duke pasur parasysh vazhdimisht pasojat e veprimeve të tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit;
VI-B.12	vendi ynë është një shoqëri multikulturore/multi-etnike në të cilën jetojnë anëtarë të kulturave/etnive të ndryshme dhe secili qytetar të saj është përgjegjës për të kontribuar në shkëmbimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në interes të të jetuarit së bashku në një shoqëri të integruar dhe etnikisht kohezeve;

VIII. Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi /nxënësjat di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e afërt dhe atë të gjerë dhe të analizojë ndërlidhjen dhe varësinë reciproke të tyre;
<i>Nxënësi/nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.4	diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit të kulturës së vet nga të tjerët.

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **UNË DHE TË TJERËT – FAMILJA IME, SHTËPIA IME, MIQTË E MI DHE MJEDISI KU JETOJ**

Gjithsej: 24 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të shqiptojë drejt tingujt e gjuhës standarde shqipe, duke bërë dallimin mes shqiptimit të tingujve në shqip dhe në gjuhën amtare;
2. me dëgjim t'i njohë fjalët e theksuara saktë dhe t'i theksojë saktë fjalët e mësuara sipas rregullave për theksim në gjuhën standarde shqipe;
3. të përdorë leksik/fjalë me të cilat prezanton saktë veten dhe leksik/fjalë dhe shprehje të përshtatshme kur njihet me njerëz të tjerë;
4. t'i emërtojë, t'i tregojë dhe t'i prezantojë anëtarët e familjes së tij, profesionet e tyre, miqtë dhe të përshkruajë shtëpinë dhe mjedisin, duke përdorur trajtat e emrave, të mbiemrave, të përemrave dhe të foljeve *jam* dhe *kam*;
5. të përdorë fjalë nga fjalori i gjuhës shqipe dhe të zbatojë kuptimin e saktë të tyre në një kontekst/situatë komunikimi;
6. të lexojë tekste në gjuhën shqipe me shmangie të caktuara në shqiptim dhe në lidhjen e fjalëve;
7. t'u përgjigjet pyetjeve, të nxjerrë fjalë e shprehje të panjohura, të njohë përgjigjen e saktë, të ndërtojë fjali të shkurtra me përmbajtje të thjeshtë, në lidhje me tekstet që i dëgjon dhe i lexon.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

a) Modelet e komunikimit

- Prezantimi i vetes dhe prezantimi i njerëzve nga mjedisi ku jeton, njohja me njerëz të tjerë.
Une quhem Marko. Mbiemri im është Jovanoski. Kam 12 vjet. Nuk jam në klasën e pestë. Ajo quhet Merima. Ai është shoku im. Ky është vëllai im. Ai është shoku im Agimi.
Unë kam lindur më ... Jetoj në rrugën ...
Si quhesh ti? Nga je? Sa vjet ke? Ku mëson?
Me kë shoqërohesh më shumë? Ata janë vëlla dhe motër.
Ajo është mbesa jote.
- Përshkrimi i karakteristikave personale dhe karakteristikave të njerëzve nga mjedisi ku jeton, anëtarëve të familjes dhe profesioneve të tyre:

Standardet për vlerësim:

- Prezanton veten dhe personat e tjerë me shprehje të sakta të thjeshta, i tregon të dhënat për lindjen dhe vendbanimin.
- Përdor drejt modele të thjeshta gjuhësore për t'u njohur me njerëz të tjerë.
- I tregon anëtarët e familjes dhe lidhjen e tij/saj farefisnore me ta, si dhe marrëdhëniet farefisnore të anëtarëve të familjes.
- Prezanton cilësitë e tij/saj personale më të rëndësishme.
- Tregon karakteristika të njerëzve nga mjedisi ku jeton, duke i përdorur drejt: trajtat e foljes *jam*, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dhe lidhëzën *dhe* për të lidhur pjesë të fjalisë.
- Emërton profesionet e anëtarëve të familjes së tij/saj të ngushtë dhe të gjerë, duke përdorur leksikun e duhur.
- Parashtron dhe u përgjigjet pyetjeve që lidhen me karakteristikat personale, karakteristikat e njerëzve të familjes së ngushtë dhe me profesionet e tyre.

<i>Unë mbaj syze. Kam një vëlla dhe një motër. Ai është shumë i vlefshëm. Ne nuk kemi dajë, kemi teze. Ajo është e buzëqeshur. Gjyshja ime është e lodhur. Fqinjët tanë janë njerëz të mirë. Shoku im nuk është përtac. Çfarë nxënësi është Tomi? Unë nuk jetoj në apartament. Arta dhe Fisniku jetojnë me nënën, babanë, gjyshen dhe gjyshin. Kush është ky? Çfarë punon ai/ajo? Babai im është pastičer, bën bakllava. Motra ime Vesna di të vallëzojë. Xhaxhai im është bujk. Hajuli luan hendboll.</i> • Përshkrimi i shtëpisë dhe rrethit të tij/saj; veprimtaritë e zakonshme në shtëpi <i>Kjo është shtëpia ime; atje është kuzhina pranë saj është dhoma e pritjes, kurse kjo dhomë është e imja. Në dhomën e pritjes ka një tavolinë të vogël, dy kolltuqe dhe një divan, një komodë dhe piktura artistike. Ky shtrat është i imi. Në atë tryezë unë shkruaj. Nën tryezë ka qilim. Mbi tryezë ka një vazo.</i> <i>Në shtëpi unë ndihmoj për pastrimin e oborrit. Në shtëpi unë pres bukën, pastroj dhomën, fshij pluhurin dhe blej ujë. A ndihmon ti në shtëpi? Çfarë ndihmon ti në shtëpi?</i> • Ndërgjegjësimi për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zbukurimin e mjedisit	• Përshkruan shtëpinë dhe rrethinën e tij/saj me leksikun e duhur dhe i tregon pjesët e mobiljeve dhe të pajisjeve, duke përdorur drejt trajtat e përemrave dëftorë, përemrave pronorë dhe të foljeve <i>jam</i> dhe <i>kam</i>. • Tregon përgjegjësitë dhe veprimtaritë e tij në shtëpi dhe i krahason me ato të anëtarëve të tjerë. • Tregon veprimtari për ruajtjen e higjienës së sipërfaqeve të gjelbra dhe të bukurive të tjera natyrore. • Dëgjon, kupton dhe u përgjigjet pyetjeve/informacioneve për ndotjen e mjedisit. • Arsyeton se si duhet të duket mjedisi sipas një ilustrimi ose fotografie të paraqitur. • Përdor drejt shprehjet për urim, falënderim, lutje, kërkim faljeje, shprehje respekti në gjuhën shqipe; • I krahason fjalët dhe shprehjet për urim, falënderim, lutje, kërkim faljeje, shprehje respekti në gjuhën e tij me format në gjuhën shqipe dhe i tregon ngjashmëritë dhe dallimet. • Shkruan një tekst të përshtatshëm për kartolinë, ftesë etj.
---	---

<i>Vendet e mia të preferuara përreth janë... Kënde lojërash më të bukura ka në... Më së shumti dua të pi ujë nga... Më së shumti dua të shkoj në piknik në... Fatkeqësisht, në lumë ka shumë shishe plastike. Në foto shoh bar, një dru dhe dy stola.</i> • Komunikimi dhe të shprehurit me mirësjellje – urimi (festa, ditëlindja, suksesi), falënderimi, lutjet, kërkimi i faljes, shprehja e respektit; krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve pozitive dhe tolerante mes njerëzve) <i>Faleminderit! Urdhëroni! Sa dhuratë e bukur! Më falni për vonesën! Më vjen keq. A mund të hyj? Të lutem më telefono. Jo, faleminderit, nuk jam e uritur. Urdhëroni te ne për Krishtlindje.</i>	
b) Leksiku Familja, miqtë, shtëpia • Emrat – profesione: mësuese, muzikant, piktor, kozmonaut, parukier, mekanik, polic, inxhinier, mjek, shofer... <i>Familja (nëna, babai, djali, vajza, vëllai, motra, gjyshi, gjyshja), farefisi (xhaxhai, halla, daja, teza,...);</i> <i>Pjesë të shtëpisë (ambienti, dhoma, dhoma e pritjes, kuzhina, dhoma e gjumit, dhoma e fëmijëve...);</i> Emrat e festave; • Përemrat – përemrat dëftorë: <i>ky, kjo, këta, këto</i> • Përemrat pronorë: <i>i imi, i yti, i tij, i saj</i>	• Përdor emrat që tashmë i ka mësuar që tregojnë profesione, mobilje dhe pjesë të shtëpisë në shembuj të rinj. • Lidh drejt profesionet me veprimtaritë që rrjedhin nga profesioni i caktuar. • Emërton dhe numëron sendet dhe mobiljet që gjenden në ambientet e shtëpisë së tij/saj. • Tregon festat më të rëndësishme shtetërore dhe festat më të rëndësishme të bashkësive etnike në vendin ku jeton, duke përdorur emrat e përveçëm. • Lidh drejt pjesëtarët e bashkësive etnike në vendin ku jeton me festat fetare dhe kombëtare që ato bashkësi etnike i festojnë, duke përdorur emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm dhe përemrat pronorë. • Përdor trajtat e përemrave dëftorë në fjali të shkurtra me emrat që tashmë i ka mësuar. • Krijon fjali/shprehje të shkurtra duke i përdorur foljet në kontekstin e duhur. • Ndërton fjali të shkurtra me lidhëza dhe parafjalë (<i>dhe, edhe, ose, kurse, por; në, nën, mbi, pranë</i>).

• Foljet: <i>jam, jetoj, pëlqej, dua, ngrihem, kthehem, kërkoj falje, urdhëroni, a mund, flas, lexoj, shikoj</i> • Lidhëzat dhe parafjalët: <i>dhe, edhe, ose, kurse, ndërsa, por; në, nën, mbi, pranë</i>	
c) Fonetika dhe drejtshqiptimi • Shqiptimi i drejtë i tingujve të sistemit të tingujve të shqipes; Klasifikimi i tingujve • Theksi	• Shqipton drejt tingujt e sistemit të tingujve të shqipes duke i kushtuar kujdes të posaçëm shqiptimit të zanoreve <i>ë</i> dhe <i>y</i> dhe bashkëtingëlloreve <i>dh, l, ll, rr</i> dhe <i>th</i>. • Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret në një fjalë të caktuar. • Ndan saktë fjalët në rrokje. • Riprodhon fjalë që tashmë i ka mësuar duke i shqiptuar me theksim të saktë, kur lexon dhe kur flet.
ç) Strukturat gramatikore Emrat • Llojet e emrave: të përveçëm (emrat e personave dhe emrat e termave gjeografikë - qytete, fshatra dhe vende: <i>Unë jam Toni. Jam nga Kumanova.</i>); të përgjithshëm (vetëm emrat konkretë: <i>shtëpi, karrige, tavolinë</i>) • Kategoria gramatikore e gjinisë dhe e rasës tek emrat • Përemrat - Përemrat vetorë Trajtat e përemrave vetorë për funksionin e kundrinës së drejtë dhe të kundrinës së zhdrejtë: <i>atë e, ata i, ato i; atij i, asaj i, atyre u.</i> • Përemrat dëftorë (<i>ai, ajo, ata, ato, ky, kjo, këta, këto</i>) • Foljet - përdorimi në vetën dhe në numrin e duhur • Lidhëzat	• Dallon shembujt e emrave të përveçëm dhe të përgjithshëm. • Ndërton (4-5) fjali duke përdorur emra të përveçëm dhe të përgjithshëm. • Dallon emrat sipas kategorive gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës. • Përdor drejt emrat sipas kategorive gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës në komunikimin me gojë e me shkrim. • Identifikon përemrat vetorë duke i treguar pjesëmarrësit në bisedën/situatën e të folurit: folësi (<i>unë</i>), bashkëbiseduesi (<i>ti</i>), personi/objekti për të cilin flitet (<i>ai/ajo</i>). • Identifikon dhe përdor trajtat e përemrave vetorë për kundrinorin e drejtë dhe për kundrinorin e zhdrejtë. • Identifikon dhe përdor përemrat dëftorë në situata të ndryshme të të folurit. • Njeh trajtat e foljeve kundrrjet pjesëve të tjera të ligjëratës. • Dallon foljet sipas kategorive gramatikore të vetës dhe të numrit dhe i përdor ato drejt. • Dallon trajtën pohore dhe mohore të foljeve <i>jam</i> dhe <i>kam</i> dhe i përdor ato drejt. • Dallon lidhëzat kundrejt pjesëve të tjera të ligjëratës në përdorimin e tyre në fjali.

Kuptimi dhe përdorimi i lidhëzave që lidhin gjymtyrë të fjalisë dhe pjesë të fjalisë së përbërë: <i>Unë dhe Gylsheni ulemi në bankën e njëjtë. Ai blen mollë, dardhë dhe rrush.; Ti lexon, kurse ajo shkruan. Ai di shqip, por nuk di turqisht.)</i>	
d) Sintaksa • Përdorimi i togfjalëshave emërorë (grupi emëror): <i>qytet i madh, shokët e mi</i> • Fjalitë e thjeshtë	• Përdor drejt shprehjet e ndërtuara nga emri dhe mbiemri në fjali. • Ndërton fjali dhe identifikon renditjen e drejtë dhe jo të drejtë të fjalëve në një fjali të thjeshtë.
dh) Të lexuarit me të kuptuar dhe të dëgjuarit me të kuptuar; të shkruarit • Të dëgjuarit dhe të lexuarit e teksteve të shkurtra me leksik të thjeshtë, dialogë dhe fjali me strukturë të thjeshtë gramatikor • Të shkruarit (në mënyrë të pavarur ose me diktim)	• Dëgjon dhe lexon fjalë të reja, dialogë dhe tekste të shkurtra. • Dëgjon, lexon dhe u përgjigjet pyetjeve të shkurtra lidhur me dialogë dhe tekste të shkurtra. • Shkruan një dialog të shkurtër sipas një modeli të dhënë. • Shkruan tekst të shkurtër të lidhur (4-5 fjali) me rend të drejtë të gjymtyrëve në fjali. • Përdor drejt shkronjën e madhe kur shkruan emrat, mbiemrat dhe pseudonimet, emrat e kafshëve, emrat e institucioneve, shteteve, rajoneve. • Përdor drejt pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditjen kur shkruan me diktim ose në mënyrë të pavarur.
e) Përmbajtjet ndërkulturore: • Çfarë na lidh dhe çfarë na bën të ndryshëm • Festat dhe zakonet e festimit: Urimi i Buzmit, Krishtlindjeve, Ditës së Ujit të Bekuar, Shën Savës, Bajramit, Pashkëve, Shën Gjergjin, Ditën e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, Ditën Ndërkombëtare të Boshnjakëve, Ditën Ndërkombëtare të Romëve, Ditën e Gjuhës Turke etj. <i>(urimi i festave familjare, ditëlindjet dhe përvjetorët, urimi i ardhjes në jetë i një anëtar të ri në familje dhe i sukseseve të ndryshme, ndërtimit të një shtëpie të re, mirëpritja e mysafirëve)</i>	• Njeh elementet bazë të kulturës: gjuhën, zakonet, traditën, ushqimin, folklorin. • Shpjegon ndikimin e ndërsjellë të kulturave të bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë së bashku. • Njeh festat karakteristike të bashkësive etnike në vend që lidhen me identitetin e tyre kulturor dhe e tregon kuptimin e tyre. • Njeh Bajramin, Krishtlindjet dhe Pashkët si festa fetare dhe përshkruan zakonet karakteristike të kremtimit të tyre • Njeh dhe përdor përshëndetjet dhe urimet karakteristike në situata të ndryshme. • Njeh dhe paraqet nëpërmjet të frazave të shkurtra dallimet dhe ngjashmëritë në kulturën e festimeve dhe urimeve, që tashmë i ka mësuar.

Shembuj të aktiviteteve:

(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)

- Nxënësit bëjnë kartë të identitetit të tyre në një fletë mësimore me udhëzimet e dhëna : portretizim i shkurtër , emri dhe mbiemëri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi. Nxënësit fillimisht punojnë individualisht dhe më pas në çift gojarisht e prezantojnë punën e bërë.
- Nxënësit janë në një festë shkolle, ecin nëpër klasë dhe takojnë/njohin “nxënës nga klasat e tjera”. Për shembull: *Sa vjeç je? Cila klasë je?, Me kë shoqërohesh?*
- Nxënësit sjellin fotot e tyre dhe të familjarëve të tyre. Numërojnë anëtarët e familjes duke përdorur shprehje të përshtatshme (përemra dëftorë, foljen *jam* , leksik për marrëdhëniet farefisnore). P.sh.: *Ky është vëllai im. Quhet Esad. Kjo është motra ime, quhet Esin. Ata janë vëlla dhe motër. Ajo është mbesa jote.*
- Nxënësit në mënyrë të pavarur prezantohen me ndonjë cilësi apo karakteristikë të tyre: *mbaj syze, luaj në kitarë...*
- Nxënësit nëpërmjet vizatimit ose fotografisë, nxjerrin në pah disa nga tiparet e tyre ose tipare të njerëzve të mjedisit ku jetojnë, duke i përdorur saktë: foljen *jam*, format e përemrave vetorë dhe lidhëzën *dhe / edhe* për të lidhur pjesë të fjalisë: *Ajo është e lumtur. Ai është i buzëqeshur. Ata gëzohen edhe unë gëzohem me ta.*
- Nxënësit punojnë në çifte. Një nxënës ka një fotografi të një profesioni të caktuar, për shembull mjek /mësues/mekanik... Ai duhet të përshkruajë profesionin e shokut të klasës, dhe shoku i klasës përpiqet të vizatojë atë që dëgjon dhe më pas t'i krahasojnë vizatimet. *Ai është mjek, mban syze, stetoskop, mantel të bardhë. Ajo është mësuese. Ajo mban ditar, libra, fletore, vegla mësimore dhe shumës.*
- Nxënësit luajnë një lojë: Çfarë po punon ajo/ai? I tregojnë profesionet dhe çfarë bën/punon personi që e ka atë profesion (veprimtarinë e tij/saj).
- Nxënësit përmes vizatimit paraqesin shtëpinë e tyre ose një dhomë të caktuar, duke përdorur drejt trajtat e përemrave dëftorë dhe foljet *kam* dhe *jam* ; p.sh. *Kjo është shtëpia ime. Ai ka shtëpi të madhe. Ajo ka shtrat të vogël. Në sallon ka një divan të madh dhe dy kolltuqe.*
- Nxënësit në çift i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe përgjigjen:- *Cilat janë angazhimet tua në shtëpi? Punët e mia në shtëpi janë: të rregulloj shtratin, të kujdesem për higjienën në shtëpi, të bëj/shkoj në treg me prindërit e mi, të ndihmoj sa herë që nevojitet. - Cilat janë përgjegjësitë e tua si nxënës i klasës së gjashtë? Përgjegjësitë e mia si nxënës i klasës së gjashtë janë të mos vonohem, të bëj detyrat e shtëpisë, të jem i vëmendshëm gjatë orëve.*
- Nxënësit nëpërmjet vizatimit, paraqesin aktivitetin e tyre dhe aktivitetin e anëtarëve të tjerë të familjes së tyre. Vizatimin e përshkruajnë/sqarojnë gojarisht, duke përdorur saktë përemrat dëftorë dhe foljet *kam* dhe *jam*. Për shembull: *Ky është oborri im. Unë mbjell lule. Gjyshja po ujit kopështin. Ky është vëllai im, ai fshin pluhurin. Kjo është nëna ime, ajo gatuan.*
- Nxënësit ndahen në grupe, luajnë lojën “Shtëpi”. Secili grup përshkruan shtëpinë e tij.
- Nxënësit simulojnë situatë dhe lusin njëri-tjetrin që të bëjnë ndonjë punë në shtëpi, në oborr, në rrethin e vet (*Të lutem.....*).
- Diskutim/bisedë: Në çfarë mënyre i ndihmoni anëtarëve më të moshuar të familjes?

- Nxënësit simulojnë situata nga jeta e tyre reale. Ata ndahen në dy grupe. Garë “*Kush do ta mirëmbajë më mirë sipërfaqen e gjelbër në lagjen tonë?*” Njëri grup e shkel barin, i hedh mbeturina, nuk i ujit lulet. Grupi tjetër i hedh mbeturinat në një kosh, i ujit lulet, nuk e shkel barin. Secili grup përshkruan/sqaron aktivitetin e tij.
- Nxënësit marrin ilustrime me shembuj për ndotjen e mjedisit. Ata i tregojnë të gjitha format e ndotjes së mjedisit.
- Nxënësit shikojnë një vizatim që tregon mjedis jashtëzakonisht të pastër. Ata e përshkruajnë si shembull i një eko-mjedisit të pastër.
- Nxënësit simulojnë situata nga jeta e tyre e përditshme dhe i përdorin shprehjet:- *Urime diplomimin! - Të lutem të më ndihmoni! - Me fal, nuk desha t’ju lëndo.*
- Nxënësit punojnë në grupe. Ata bëjnë kartolina/ftesa dhe më pas shkruajnë një tekst të përshtatshëm për kartolinën/ftesën.
- Nxënësit ndahen në çifte ose grupe. Secilit çift/grup i jepet një fletë me emrin e ndonjë profesioni që duhet t’ua shpjegojë pa fjalë shokëve të klasës. Të tjerët përgjigjen duke përdorur shprehjet, p.sh: *Ti je parukier/e; Jo,unë nuk jam mekanik etj.*
- Nxënësit sjellin foto me profesione të ndryshme (inxhinier/e, mekanik/e, mjek/e, mësues/e etj.) të anëtarëve të familjes së tyre duke i treguar edhe lidhjet familjare edhe profesionet e tyre, p.sh. *Babai im është bujk*, pastaj bëjnë lidhjen - *Babai im dhe babai i Seldës janë / bujq dhe shpjegojnë, Ata janë vëllezër.*
- Nxënësit bëjnë/modelojnë një dhomë. Secili nxënës nga shtëpia sjell një kuti këpucësh, lapustila (fllomasterë), kuti shkrepsash, gërshërë, ngjitës, letër, letër ngjitëse. Ndahen nxënësit në çifte dhe secilit çift i jepet detyrë të bëjnë modelin e një dhome sipas marrëveshjes. Pas përfundimit të aktivitetit, secili çift e ka për detyrë të prezantojë punimin e tyre, duke përshkruar se çka ka në dhomë.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe bëjnë një *puzzle* (përputhëse) me temën “*Dhoma ime*”. Çdo nxënës merr një zarf me pjesë të *puzzle*-it. Kur bashkohen pjesët, formohet një dhomë. Çifteve u jepen *puzzle* të ndryshme. Çdo çift ka 10 minuta kohë për të bashkuar pjesët dhe për të formuar *puzzle* – in më pas ta prezantojë duke përshkruar, për shembull: *Kjo është dhoma e ndenjes. Në këtë dhomë ndenje ka një TV të madh dhe një kolltuk të verdhë. Kjo është një dritare e madhe dhe ky është divani.*
- Nxënësit diskutojnë në temën: Kush çfarë feston?
- Nxënësve u jepet një vizatim me ilustrim të elementeve bazë të kulturës, nxënësi duhet të shkruajë se për cilën kulturë bëhet fjalë. (Kostumi popullor karakteristik për kulturën maqedonase/shqiptare/serbe/turke...).
- Nxënësit punojnë në grup dhe kanë për detyrë të simulojnë: të urojnë festën, të urojnë një sukses të arritur në një garë sportive etj. (*Gëzuar Pashkët, Gëzuar Bajramin, Gëzuar Shën Gjergjin etj.; Urime për suksesin!*).
- Simulime: Dhënia dhe marrja e dhuratave (*Sot është ditëlindja ime! Sot është dita e emrit tim!*).
- Nxënësit luajnë lojën “*Memoria*” - (nxënësit ndahen në disa grupe në të cilat shkruhet (për shembull festë, ditëlindje, kremte) dhe duhet të mbajnë mend si t’i përdorin drejt shprehjet...*Gëzuar Bajramin, Gëzuar ditëlindjen etj.*)
- Nxënësit dëgjojnë audio-inçizim për kuptimin e një feste të caktuar/shikojnë një video dhe më pas përshkruajnë festat (audio-inçizimi është siguruar që më parë dhe në të ndëgjohet/përpunohet një temë për rëndësinë e një feste të caktuar). Nxënësit në fund të orës marrin një fletë mësimore me pyetje: *Për cilën festë u fol në video-inçizim ? Si u përshëndetën me njëri-tjetrin?*
- Nxënësit motivohen nga një material vizual/pamor për temën që kanë mësuar dhe hartojnë fjali/thënie të shkurtra duke përdorur foljet në kontekst të përshtatshëm, p.sh. *Unë jam Mersiha banoj në... kam 12 vjet/Jam 12 vjeçe. Më pëlqen të lexoj dhe të pikturoj. Për ditëlindje më dhuruan ngjyra uji.*

- Nxënësve u jepet një foto me ilustrim ku është paraqitur ndonjë ambient i shtëpisë. Ata kanë për detyrë të hartojnë fjali të shkurtra me lidhëza dhe parafjalë (*dhe, edhe, ose, kurse, por; mbi, në, nën, mbi,*) të cilat i ndajnë mes vete me zë të lartë dhe i korrigjojnë gabimet me njëri-tjetrin.
- Nxënësve u jepet një listë me fjalë, të cilat, në pozicione të ndryshme, i përmbajnë tingujt që duhet të ushtrohen (*ë, y, dh, l, ll, rr dhe th*). Ata motivohen të thonë vetë një fjalë që përmban ndonjërin nga tingujt që duhet t'i ushtrojnë për shqiptim.
- Nxënësit shikojnë një material audio-vizual që tregon artikulin e tingullit / tingujve të caktuar, pra shqiptimin e zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Ata i dallojnë dhe i ndajnë tingujt në zanore dhe bashkëtingëlloret. Më pas shkruajnë fjalë dhe sipas udhëzimit të mësimdhënësit/es i ndajnë ato në rrokje dhe vërrejnë se rrokja ka bashkëtingëllore dhe zanore.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe secili çift ka një kartë me ngjyrë të kaltër dhe një të kuqe. U jepet një listë e shkurtër me fjalë dhe ata i ndajnë fjalët në rrokje. Secili çift e ndan në rrokje listën e fjalëve dhe i shqipton ato me zë të lartë. Shokët e klasës e ngrenë kartën me ngjyrë të kaltër për ndarjen e saktë, ose të kuq për ndarjen e gabuar të fjalëve në rrokje. Mësimdhënësi/ja verifikon saktësinë në tabelë.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër, pastaj tekstin e lexojnë vetë me zë duke pasur kujdes për theksimin e fjalëve.
- Nxënësve u jepet një listë me emra të përveçëm dhe emra të përgjithshëm, i ndajnë ato dhe japin nga një shembull me një fjali të shkurtër, duke i përdorur të gjithë emrat.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me udhëzimin: “Plotësoje vendin bosh në tabelën e dhënë.” Në tabelë janë dhënë emrat në njëjës ose në shumës dhe nxënësit duhet të plotësojnë vendet bosh. Shembull: *televizori- _____; _____-tavalinat.... etj.*
- Nxënësit ndahen në grupe, secili grup i jepet një listë me emra, dhe nxënësit i thonë ato duke ua ndërruar gjininë ose numrin (p.sh. nxënës – nxënëse; mjek – mjeke; divan – divane; pikturë – piktura). Më pas formojnë dhe shkruajnë fjali të shkurtra, të cilat i shënojnë në tabelë dhe e kontrollojnë saktësinë e tyre.
- Nxënësit simulojnë një bisedë duke përdorur në mënyrë të drejtë përemrat vetorë. Shembull: *A ke ti dhomën tënde? Unë kam dhomën time. A ke ti një top? Unë nuk kam, por ajo ka një top.*
- Nxënësve u jepet karta me ilustrime. Secili ka për detyrë të thonë një fjali duke përdorur foljen e përshtatshme në numrin dhe në vetën e duhur.
- Nxënësit e luajnë lojën: “*Ka - nuk ka*”. Shembull: *Aleksandri ka kapelë të verdhë, por nuk ka kapelë të gjelbër. Maja ka stilolaps të kuq, Behia ka një të kaltër, ndërsa Agimi nuk ka stilolaps, ai ka lapsa.*
- Nxënësve u jepet një listë e vogël emrash. Për secilin emër shkruajnë mbiemra aq sa dine, duke i përshtatur ato në gjini dhe në numër.
- Nxënësit ushtrojnë përdorimin e lidhëzave. Shembull: *Bleva mollë, dardha ___ bukë në dyqan. Unë jam duke fjetur, ___ju jeni duke bërë detyrat e shtëpisë. Ai di maqedonisht ___ nuk di turqisht etj.*
- Nxënësve u jepen fjali që kanë renditje të saktë dhe të gabuar të fjalëve. Me shenjën saktë (**v**) i shënojnë fjalitë e sakta, ndërsa ato të që kanë renditje të gabuar të fjalëve, i komentojnë dhe i korrigjojnë.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst, i gjejnë fjalët e panjohura dhe më pas i riprodhojnë ato.
- Nxënësit në çift lexojnë një dialog dhe më pas lexojnë edhe pyetjet lidhur me të. Ata përgjigjen me radhë para të gjithëve në klasë.
- Nxënësve u jepet një listë me fjalët të reja të sapomësuar dhe më pas ata shkruajnë një dialog të shkurtër sipas një modeli të dhënë.
- Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër me renditje të drejtë të fjalëve në fjali për përmbajtjen që e mësojnë (profesionet, shtëpia, festat ...)

- Nxënësve u jepet një fletë pune me fjali, në të cilat të gjitha fjalët janë shkruar me shkronja të vogla. Nxënësit duhet ta përdorin shkronjën e madhe aty ku është e nevojshme, sipas rregullave të drejtshkrimit lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm në (P.sh: *unë çdo javë shkoj në vodno me vëllain tim marko. ajlini nesër vjen nga gjermania. ajo ka shumë miq nga evropia.*)
- Nxënësit shkruajnë me diktim. Më pas ndahen në çifte, kontrollojnë njëri-tjetrin sipas shembullit të saktë, të shkruar në tabelë, lidhur me përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit.
- Nxënësit luajnë lojën “*Memoria*”. Ata marrin karta me një fjalë, një ilustrim të ndonjë ushqimi ose kostumi dhe e lidhin atë me komunitetin etnik, të cilit i referohet ilustrimi në kartë.
- Nxënësit shikojnë dhe komentojnë ilustrimet në të cilat ka një tekst: *Ky është Mustafai, ai po feston Bajramin. Ky është Kostadini, ai po feston Krishtlindjet. Këto janë Leila dhe Fatma dhe po festojnë Bajramin. Kjo është Milica, ajo po feston Pashkët.*
- Nxënësit ndahen në grupe, bisedojnë me njëri-tjetrin dhe simulojnë një festë të përbashkët duke sjellë ushqime tradicionale në festë..
- Nxënësit ndahen në grupe, secili grup ka për detyrë të urojë një festë të caktuar. Secili grup i shpreh urime grupit tjetër.
- Nxënësit formojnë nga tri fjali dhe bëjnë një vizatim, në të cilin do të shprehin gjërat e ndryshme dhe të përbashkëta në lidhje me festa dhe me kultura të ndryshme.
- Nxënësit realizojnë një aktivitet projektues “*Muzika tradicionale e fqinjëve të mi*”. Ata ndahen në grupe, mbledhin të dhëna dhe regjistrime për muzikën e një bashkësie tjetër etnike dhe e prezantojnë atë gjatë orëve.

Tema: **SHKOLLA, VENDBANIMI, INTERESAT DHE KOHA E LIRË**

Gjithsej: 28 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të nxisë ose të përfshihet në një bisedë në lidhje me një kontekst/situatë të përshtatshme komunikimi;
2. të shqiptojë drejt fjalët e reja dhe t’i përdorë në kontekste të përshtatshme gjuhësore;
3. të prezantojë shkollën e tij/saj dhe të japë drejtime për orientimin në hapësirë;
4. të numërojë aktivitetet që realizohen gjatë orës së mësimi/pushimit, pushimit veror/dimëror, gjatë lojës dhe gjatë udhëtimit;
5. të përshkruajë dhe të krahasojë me të tjerët, vendin ku jeton duke përdorur emra, mbiemra, numërorë, përemra pronorë;
6. të hartojë fjali dhe të marrë pjesë në bisedë duke përdorur forma të sakta gramatikore për tema të shkollës dhe të veprimtarive të shkollës, për përshkrimin e vendbanimit, orientimin në hapësirë dhe trafik, për hobi dhe për sport;
7. të riprodhojë dhe të shpjegojë me fjalët e tij përmbajtjen e një teksti të dëgjuar ose të lexuar;
8. të shkruajë një tekst të shkurtër sipas udhëzimeve ose pyetjeve të përcaktuara duke përdorur shprehje dhe fjalë që sapo i ka mësuar.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Standardet për vlerësim:

a) Modelet e komunikimit Shkolla ime Përshkrimi i shkollës dhe jetës shkollore; aktivitetet e zakonshme të shkollës (fshirja e dërrasës së zezë, zgjidhja e detyrave në klasë, pjesëmarrja në sporte dhe gara të tjera shkollore dhe aktivitete jashtëmësimore) <i>Kjo është shkolla ime.... Shkolla ime quhet... Unë jam në klasën e Në shkollë ka klasa / kabinete për.../ Zyrë për ... Në shkollë punojnë: mësues, pedagog, psikolog, defektolog... Unë ulem në bankën e tretë. Pranë kujt je ulur? Unë jam ulur pranë Anës. Unë jam ulur pranë Mertit. Më pëlqen të shkruaj në tabelë/dërrasë. Mësuesja ka shumë libra në bankë/tavolinë. Pas mësimit shkojmë në ëmbëltore. Maja vjen në shkollë me një karrige me rrota</i> Rruga nga shtëpia deri në shkollë (<i>rruga ime nga shtëpia deri në shkollë, bankë, spital, treg, supermarket, dyqan, qendër tregtare, postë</i>) Përshkruaje rrugën tënde për në shkollë. <i>Rrugës për në shkollë kaloj pranë një tregu, një qendre tregtare dhe një poste.</i> Pushimi dimëror dhe veror <i>Kur fillon pushimi dimëror? Kur nisin pushimet verore? Në cilët muaj shkojmë në shkollë? Në cilët muaj jemi me pushime?</i> <i>Aktivitetet gjatë pushimeve verore dhe dimërore</i> <i>Ejani të luajmë: Mos u zemëro, njeri / Monopol / Letra! Po, ejani të luajmë.</i> <i>Nuk mundem tani, do të luajmë më vonë.</i>	- Përshkruan shkollën e tij, klasën dhe mjedisin me leksikun e duhur. - Numëron aktivitetet e orëve mësimore. - Tregon aktivitete dhe ngjarje nga shkolla. - Ilustron aktivitetin e vet dhe aktivitetet e të tjerëve në shkollë dhe jashtë saj. - Parashtron saktë pyetje dhe jep udhëzime për orientimin në hapësirë/vend dhe në kohë. - Shpjegon rrugën për në shkollë, duke komunikuar me shprehje të mirësjelljes. - Parashtron pyetje të përshtatshme sipas situatës së bisedës. - Tregon aktivitetet që do të bëjë gjatë pushimeve: lojëra dhe udhëtime. - Tregon planet e veta duke përdorur kohën e ardhme në fjali. - Numëron muajt dhe stinët e vitit. - Përshkruan mjedisin e vet dhe përmend veçoritë më të rëndësishme të vendbanimit duke përdorur leksikun e përvetësuar. - Përshkruan vendbanimin e vet dhe bën krahasimin me mjediset e tjera të jetesës (fshat, qytet, lagje). - Emërton saktë objektet dhe institucionet që ndodhen në vendbanimin e tij. - Përdor leksikun e duhur kur shpjegon lëvizjen e vet në trafik. - Tregon drejtimet e lëvizjes, duke shpjeguar sjelljen në trafik. - Parashtron saktë pyetje për orientimin në hapësirë dhe ndjek udhëzimet. - Përshkruan një rrugë/mënyrë lëvizjeje nëpër mjedis në situata të bisedës. - Shpjegon dhe jep udhëzime se ku jeton. - Përshkruan në hartë vendbanimin e tij dhe objektet e rëndësishme të vendbanimit. - Parashtron dhe u përgjigjet pyetjeve në lidhje me udhëtimin, kohën e nisjes dhe mbërritjes, blerjen e biletave. - Përdor shprehje sipas këtyre modeleve gjuhësore: <i>dua të...; Nuk dua të...; Më pëlqen...; Nuk më pëlqen...; A dëshiron të...; A mund të...</i> - Tregon hobin e tij, interesat dhe aktivitetet e ndryshme që bën gjatë kohës së lirë. - Jep shembuj me shprehje që ka përvetësuar për interesat dhe aktivitetet e ndryshme që bëjnë familjarët dhe shokët e tij/saj gjatë kohës së lirë.
--	--

Planet e udhëtimit (përdorimi i kohës së ardhshme) Këtë verë/dimër do të shkoj në Strugë/në Tetovë/në Mavrovë/në det në... • Vendi im <i>Ne vendin tim (fshat, qytet, lagje) ka/nuk ka sheshe, bulevardë, rrugë kryesore, ambulancë, postë, qendra tregtare, bankë, kinema...</i> Trafiku dhe drejtimet e lëvizjes <i>Më falni, si mund të arrij deri nderi në A mund të më ndihmoni të shkoj në Po, shkoni djathtas/majtas;/ kthehu djathtas përgjatë rrugës ... Në anën e djathtë / të majtë është ... , prapa tregut kthehuni djathtas ..</i> <i>Unë deri në shkollë eci në këmbë. Unë udhëtoj me autobus. Unë udhëtoj me furgon (kombe). Agimi shkon në shkollë me biçikletë, kurse Mersiha shkon me trotinet elektrik.</i> <i>Ky është / atje ka: udhëkryq, vendkalim, trotuar, shteg për biçikleta.</i> <i>Rregullat e trafikut: respektimi i semaforëve, i shenjave të trafikut (komunikacionit) dhe lëvizja si këmbësor ose çiklist (Duhet të lëviz në një shteg këmbësorësh/trotuar/shtegu për biçikleta.)</i> <i>Në stacionin e trenit / e autobusit: Sa kushton bileta për në Shkup? Në çfarë ore niset autobusi/treni për në Manastir? Nga cili terminal niset autobusi/treni?</i> • Interesat, hobi dhe koha e lirë <i>Më pëlqen të lexoj libra.</i> <i>Nuk duhet të luaj lojëra kompjuterike.</i> <i>Nuk më pëlqen të këndoj.</i> <i>A të pëlqen të gatuash?</i>	• Numëron sportet dhe shpjegon se cili është sporti i tij i preferuar që e praktikon. • Numëron pajisjet dhe rekuizitat për sportin e preferuar. • Përshkruan sportistin e tij/saj të preferuar. • Tregon rregullat e lojës së ndershme, duke përdorur shprehjet që sapo ka mësuar.
---	--

<i>Ne duam të shoqërohemi me të tjerët. Më pëlqen ai libër. Gjyshi im bën byrek të shijshëm. Artanit i pëlqen të vallëzojë. Ai nuk di të shkruajë në gjuhën shqipe dhe dëshiron të mësojë. Çfarë i pëlqen të lexojë? Ku dëshiron të luajë futboll?</i> • Sporti i preferuar, pajisjet dhe rekuizitat sportive Flasim për një sport të preferuar <i>Unë luaj futboll dhe fudbollisti im i preferuar është... Si mendoni, a është ai më i miri? Sot prindërit e mi më blenë...</i> Sjellja në një garë sportive, respekti për tjetrin, për të ndryshmin nga ne	
b) Leksiku • Emrat Ambientet në shkollë: <i>zyra e arsimtarëve, zyra e drejtorit/sekretarit/defektologut/psikologut/pedagogut, sallës së sportit, korridori, klasat, biblioteka...</i> Stinët: <i>pranvera, vera, vjeshta, dimri</i> Vendbanimi: <i>fshat, lagje, qytet</i> Mjetet e transportit: <i>makinë, autobus, biçikletë, trotinet</i> Trafiku: <i>semafori, bulevardi, rruga kryesore, udhëkryqi, shenjat e komunikacionit</i> Lojëra, sport dhe argëtim: <i>futboll, tenis, basketboll, hendboll... kopsht zoologjik, aqua park, teatër, kinema...</i> • Foljet: <i>luaj, shkruaj, vizatoj, flas, bisedoj, shoqërohem</i>	• Numëron hapësirat në shkollë. • Përshkruan vendbanimin e vet duke përmendur objekte dhe institucione. • Emërton dhe numëron mjetet e transportit me të cilat udhëton në vendbanimin më të afërt. • Përdor fjalorin e duhur kur përshkruan lëvizjen në trafik. • Tregon lojërat argëtuese sportive, sportet dhe pajisjet sportive. • Tregon vendet dhe objektet që viziton në kohën e lirë.

Ndajfoljet e vendit: <i>majtas, djathtas, para, mbrapa</i>	
c) Strukturat gramatikore Emrat Kategoria gramatikore e numrit tek emrat: shumësi i emrave (shembull: <i>laps - lapsa, mur - mure; tavolinë - tavolina; shkollë - shkolla, fshat - fshatra, zog - zogji</i>) Mbiemrat Llojet e mbiemrave: mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë (mbiemrat që tregojnë numra rendorë nga një deri në dhjetë: <i>klasa e gjashtë, çmimi i parë</i>) Kategoritë gramatikore të mbiemrave – gjinia dhe numri; përshtatja e mbiemrave me emrat sipas këtyre kategorive gramatikore (<i>nxënës i ri, libër i ri, klasa e re; fletore të reja</i>) Përemrat pronorë: <i>im /ime/; yt /jote/; e tij/e saj, e vet, e tu, e tua, tanë, tona, jona, juaj; tuaj;; i/e tyre,... (veta, gjinia, numri, rasa)</i> Trajtat e përemrave vetorë për kundrinën e drejtë në njëjës dhe në shumës (<i>mua më, ty të, atë e, ne na, ju ju, ata/ato i</i>) Numërorët Numrat nga 1 deri në 100 Gjinia e numrit tre (<i>tre djem, tri vajza</i>), trembëdhjetë, tridhjetë Foljet Kategoritë gramatikore të vetës dhe numrit të foljet Kategoria gramatikore e kohës të foljet (e tashmja, e pakryera dhe e ardhmja) <i>Çfarë bën? Mësoj/lexoj/ulem. A</i>	- Dallon shumësin tek emrat. - Krijon një tekst të shkurtër (me 4-5 fjali) ku përdor saktë shumësin e emrave. - Identifikon mbiemrat dhe i përdor siç duhet duke i përshtatur me emrat. - Përdor drejt mbiemrat cilësorë dhe marrëdhëniorë në komunikimin me gojë dhe me shkrim. - Dallon marrëdhënien ndërmjet përemrave pronorë: <i>im /ime/; yt/ jote; i/e tij/saj, e vet, e tu, e tua, tanë, tona, jonë, juaj; tuaj;; i/e tyre,... (veta, gjinia, numri, rasa)</i> - Zbaton drejt përemrat pronorë në komunikimin me gojë dhe me shkrim. - Përdor saktë trajtat e përemrave vetorë për kundrinën e drejtë në njëjës dhe në shumës (<i>mua më, ty të, atë e, ne na, ju ju, ata/ato i</i>). - Njeh dhe përdor drejt numrat nga 1 deri në 100. - Dallon format e gjinisë së numrit tre (tre djem, tri vajza) në situata të ndryshme komunikimi dhe ndërtimet e numrave trembëdhjetë dhe tridhjetë. - Tregon fjalët pyetëse (<i>çfarë, kush, ku, kur, pse, sa, si?</i>). - Formon fjali duke përdorur fjalët pyetëse (<i>çfarë, kush, ku, kur, pse, sa, si?</i>). - Identifikon format e foljes ndihmëse <i>jam</i> në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme. - Formon shprehje duke përdorur kohën e duhur për të shprehur një veprim të caktuar. - Përdor drejt parafjalët (<i>mbi, nën, rreth, pranë...</i>) në komunikimin me gojë dhe me shkrim. - Përdor drejt ndajfoljet në komunikimin me gojë dhe me shkrim. - Dallon lidhëzat në raport me pjesët e tjera të ligjëratës brenda fjalisë duke i përdorur saktë ato (<i>dhe, edhe, por, kurse etj.</i>). - Identifikon rendin e drejtë dhe të gabuar të fjalëve në fjali.

<i>ishe dje në stërvitje? Po isha/nuk isha në stërvitje. Nesër do të shkoj në stërvitje.</i> Koha e tashme, e pakryera dhe e ardhmja e foljeve <i>jam</i> dhe <i>kam</i> Foljet në diatezën vetvetore (<i>lahem, krihem, vishem</i>) dhe mesore (<i>hidhem, kapem, kthehem, mbahem</i>) Kuptimi i foljeve (veprim - <i>luaj, lexoj, kërcej</i>; gjendje - <i>ulem, rri, flej, ëndërroj, mendoj</i>; dukuritë natyrore – <i>bie shi, bie borë, bubullon, vetëton, fryn erë</i>) • Fjalët pyetëse: A, vallë, çfarë; kush; ku, kur, sa, pse, si • Parafjalët dhe ndajfoljet Kuptimi dhe përdorimi i parafjalëve dhe i ndajfoljeve: <i>në, mbi, me, nga, deri, për, mbi, nën, para, prapa; dje, sot, nesër.</i>	
ç) Të lexuarit me të kuptuar dhe të dëgjuarit me të kuptuar; të shkruarit • Dëgjimi dhe leximi i teksteve të shkurtra me leksik të thjeshtë me fjali të thjeshta dhe me fjali të përbëra jo aq komplekse • Të shkruarit e një teksti të shkurtër	• Lexon dhe dëgjon me të kuptuar tekste të shkurtra, duke veçuar fjalë të panjohura nga teksti. • Parashtron dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit. • Harton një koment për atë që është lexuar në një ose dy fjali. • Lexon duke theksuar drejt fjalët dhe duke respektuar shenjat e pikësimit. • Shkruan udhëzime të shkurtra për lëvizjen në hapësirat e shkollës dhe në vendbanimin e tij/saj • Shkruan një tekst të shkurtër prej 4-5 fjalish duke përdorur leksikun e mësuar rreth hobi dhe sportit të tij/saj të preferuar. • Shkruan duke përdorur drejt shkronjën e madhe, pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen.
d) Përmbajtjet ndërkulturore • Dita e Shkollës (Patronatit)	• Përshkruan dhe shpjegon si festohet Dita e Shkollës (Patronati). • Merr pjesë në bisedë për ndeshjet sportive dhe për brohoritjet/tifozeri, për respektin ndaj tjetrit dhe të ndryshmit nga vetja.

• Sporti - vendi për shoqërim • Monumentet e vendbanimit (objektet fetare, përmendoret, zonat arkeologjike)	• Përshkruan dhe dallon sjelljen e përshtatshme dhe të papërshtatshme gjatë ndeshje sportive ose gjatë koncertit. • Tregon dhe shkruan monumentet në vendbanimin e tij/saj. • Njeh dhe ilustron dallimet në pamje të objekteve fetare.
Shembuj të aktiviteteve: <i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i> • Nxënësit bëjnë lidhjen e një figure të dhënë me një shprehje fjalësh: <i>Këta të dy po flasin. Ata janë ulur në bankë. Ajo është e lartë. Maria ka një libër të verdhë, një laps të madh të gjelbër dhe një fletore të vogël të kuqe.</i> • Nxënësit tregojnë me ilustrime dhe emërtojnë të gjitha ambientet e shkollës dhe më pas riprodhojnë njësitë leksikore. <i>Kjo është zyra e arsimtarëve. Këto janë klasa. Kjo është zyra e psikologut. Kjo është biblioteka e shkollës.</i> • Nxënësit lexojnë pyetjen në tabelë: <i>Kush çfarë bën?</i> Ata thonë një nga një fjali që përfshin një aktivitet shkollor: <i>Blerimi fshin dërrasën e zezë. Merita zgjidh një detyrë. Abduli lexon. Mara shkruan.</i> • Nxënësit paraqesin veten në një vizatim me ndonjë veprimtari karakteristike për orën mësimore ose për shkollën në përgjithësi. Më pas i ngjisin vizatimet në tabelë dhe secili nxënës thotë nga një fjali për ta përshkruar ilustrimin. • Ushtrim me gojë: <i>A mund të më thoni si të shkoj (deri) në?</i> • Nxënësit luajnë lojën “Harta”. Ata vizatojnë një hartë për të shkuar në shkollë duke improvizuar situata. <i>-Mirëdita! -Mirëdita! Si të shkoj deri në shkollën "....."?</i> • Nxënësit simulojnë situata nga jeta e përditshme duke zgjedhur një pyetje sipas një situatë specifike të të folurit. <i>-Mirëmëngjesi! - Mirëmëngjesi! - Më falni, ku është shkolla "....."? - Shkolla "....." ndodhet në fund të rrugës kryesore në të djathtë. Faleminderit shumë. Kalofsh një ditë të mbarë. - Të lutem. Ditë e mirë.</i> • Nxënësit marrin fotografi, ilustrime me fëmijë që luajnë me top, në këndin e lojërave, buzë ujit, në autobus etj. Nxënësit krijojnë një fjali bazuar në figurën që shohin: <i>Blerimi luan me top gjatë gjithë verës. Lulja udhëton për në Resnjë. Mirsadi dhe Lejla notojnë...</i> • Nxënësit luajnë lojën: <i>“Gjatë këtij pushimi do të ..”</i>. Të gjithë kanë për detyrë të thonë të paktën një fjali duke shprehur planet e tyre. • Nxënësit punojnë në çifte, radhisin shkronjat me emrat e muajve. Pastaj për çdo muaj shkruajnë nga një fjali. <i>(Në janar bie borë. Në qershor është vapë...)</i> • Nxënësit marrin kartolina me foto të stinëve. Ata konkurrojnë përmes lojës <i>“Kush i pari do ta qëllojë ?”</i>. Një nxënës merr një kartolinë dhe përshkruan stinën. <i>Kush do ta qëllojë i pari? Moti është me diell. Dita është e gjatë. Fëmijët luajnë në plazh. - Ajo stinë e vitit është vera. Nxënësi përshkruan se çfarë bëjnë zakonisht gjatë pushimeve verore.</i> • Nxënësit ilustron vendbanimin e tyre nëpërmjet një vizatimi. I ngjisin vizatimet e tyre në një hamer. Më pas përshkruajnë duke përdorur shprehjet: <i>Në vendin tim ka: dy shkolla fillore, një treg të madh, një ambulancë...</i> • Nxënësit përshkruajnë dhe krahasojnë: <i>Në Shkup ka ... por në Saraj ka ... Në Resnjë ka mollë, por jo perime.</i>	

- Nxënësit i tregojnë institucionet e vendit të tyre dhe thonë funksionin e tyre. p.sh. *Në vendin tim ka një teatër, Teatri i Dramës/Teatri Kombëtar/Muzeu i Shkencave Natyrore – Strugë.*
- Nxënësit me lodra: biçikletë, makinë, këmbësorë simulojnë lëvizje në trafik duke shpjeguar lëvizjen. p.sh. *Kthehem djathtas në udhëkryq drejt shkollës. Unë ngas drejt kalimit të këmbësorëve.*
- Nxënësit luajnë një lojë me drejtues (navigim), një nxënës drejton një makinë sportive dhe një tjetër i tregon në "kufje" se si të lëvizë (*drejt, djathtas, majtas, përpara, mbrapa...*). Nxënësit ndërrojnë rolet dhe vazhdojnë lojën.
- Nxënësit simulojnë një bisedë për drejtimit e trafikut: *Më falni, ku është ambulanca? Shkoni drejt, në fund të rrugës, pastaj kthehuni majtas, ndërtesa e tretë në të majtë me numrin 5 është ambulanca.*
- Nxënësit flasin në çifte dhe i shpjegojnë klasës se ku jetojnë: *Unë jetoj dy rrugë më poshtë, një shtëpi e verdhë në rrugën "Maqedonia".*
- Nxënësi bën hartën e tij dhe ilustron vendbanimin e tij. *Ky është vendi ... Unë jetoj në në rrugën Në vendin tim ka: bulevard/rrugë të ngushta/një rrugë kryesore Ka pesë markete të mëdha dhe tri kënde lojërash ...*
- Nxënësit ndahen në grupe: disa vizitojnë një stacion të autobusëve urbanë të qytetit, disa një stacion të autobusëve ndërqytetorë, disa të tjerë një stacion hekurudhor, ku duhet të informohen për orën e nisjes së autobusit/furgonit/trenit dhe çmimin e biletës. Grupet ndërrojnë rolet. Çdo bisedë zhvillohet para klasës.
- Nxënësit simulojnë dialogë të ndryshëm: *Çfarë ju pëlqen të bëni në kohën tuaj të lirë/ Çfarë nuk ju pëlqen të bëni? Më pëlqen të dëgjoj muzikë./Nuk më pëlqen të eci. Dëshironi të shkoni mysafir? Unë dua të shkoj mysafir./Nuk dua të shkoj mysafir.*
- Nxënësit diskutojnë për hobi, interesa dhe aktivitete të ndryshme në kohën e lirë. *Ti shkruan poezi në kohën tënde të lirë. A shkon në hendboll? Po, unë shkoj në hendboll. Çfarë dite shkon në hendboll? Unë shkoj të hënën, të mërkurën dhe të premten. Çfarë bën motra jote në kohën e lirë? Ajo vrapon dhe nget biçikletë në kohën e saj të lirë.*
- Nxënësit diskutojnë për sportet, tregojnë sportin e tyre të preferuar dhe i numërojnë pajisjet e nevojshme për atë sport.
- Nxënësit sjellin një foto të sportit dhe të sportistit të tyre të preferuar dhe i përshkruajnë ato para të tjerëve.
- Nxënësit ecin nëpër shkollë. Ata shikojnë dhe emërtojnë të gjitha ambientet e saj dhe më pas riprodhojnë njësitë e përvetësuar leksikore. p.sh. *Kjo është salla sportive dhe kjo është zyra e mësimdhënësve.*
- Nxënësve u jepen fotografi të një fshati, të një lagjeje dhe të një qyteti. Ata ndahen në tre grupe. Secili grup ka një foto. Ata shkruajnë anët pozitive dhe negative të vendbanimit që kanë në foto. Më pas paraqesin atë që kanë shkruar. P.sh. *Në foton tonë ka një qytet. Në qytet ka qendra të mëdha tregtare, ka shumë dyqane të mëdha, ka ndërtesa të mëdha, parqe për fëmijë, kënde të mëdha lojërash, një stacion treni...*
- Nxënësit punojnë në çifte, u jepen foto me mjete të ndryshme transporti. Fotot ngjiten në kurrizin e secilit nxënës. Njëri nga nxënësit përshkruan automjetin, kurse tjetri përpiket ta qëllojë dhe ta emërtojë atë. Pastaj të gjithë tregojnë se ku i përdorin mjetet e transportit. p.sh. *Biçikleta. Ka dy rrota, pedale, timon, një ulësë. Unë ngas biçikletën nëpër lagje.*
- Nxënësit luajnë lojën "Mbamendje" (Memoria). U jepen fotografi të sporteve të ndryshme dhe të pajisjeve të atij sporti. Nxënësit kanë për detyrë të lidhin sportin me pajisjen përkatëse. Pastaj krijojnë fjali të shkurtra për to, p.sh. *Futbolli luhet me top.*
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë të shkruajë dhjetë emra dhe trajtat e tyre në shumës. Më pas, duke përdorur të njëjtat emra, shkruajnë shembuj nga 4-5 fjali. P.sh. *Jani luan me shokët. Sara mpreh lapsat. Mira lexon poezi. Të gjithë i duan ëmbëlsirat.* Secili grup lexon tekstin e tij.

- Nxënësit punojnë në çifte. Njëri nxënës thotë emrin, tjetri mbiemrin dhe më pas ndërrojnë rolet. Nxënësit shkruajnë shembujt dhe më pas ua prezantojnë shokëve të klasës. *p.sh. dërrasa - e zezë, bora - e bardhë, shtëpia - e madhe, dhoma - e vogël, rruga - e ngushtë, oborri - i gjerë.*
- Nxënësve u jepen fjali me vende të zbrazura, të cilat duhet të plotësohen me mbiemra që i kanë mësuar (cilësorë dhe marrëdhëniorë).
- Nxënësit shkruajnë dialogun e paraqitur në një strip duke përdorur përemrat pronorë: *Ky është libri im i preferuar, ndërsa ky është libri i tij i preferuar.*
- Nxënësit luajnë lojën “*Thuaje numrin*”. Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë një numër, nga 1 deri në 100. Nxënësit shkruajnë dhe shqiptojnë saktë numrin. Me numrat e shkruar nxënësit shkruajnë fjali duke i kushtuar vëmendje gjinisë së numrit tre (tre/tri; trembëdhjetë; tridhjetë).
- Nxënësit lexojnë shembuj fjalish në tabelë dhe më pas u përgjigjen pyetjeve duke përdorur përemrat pyetës, si: *çfarë, kush, ku, kur, pse, sa, si*, sipas përmbajtjes.
- Nxënësve u jepen pyetje dhe përgjigje. Pyetjet duhet t'i lidhin me përgjigjet përkatëse, p.sh. *Çfarë bëje dje? Unë dje lexoja një lektyrë. Ku shkonin Ana dhe Sofia? Ato shkonin në Tetovë. Ku do të shkonin për pushime? Për pushime do të shkojmë në Ohër.*
- Nxënësve u jepet një ushtrim lidhur me përdorimin foljeve ndihmëse *jam* dhe *kam* në kohën e tashme dhe në kohën e pakryer. Fjalitë e plotësuara kontrollohen në tabelë *p.sh. Unë isha jashtë dje. Ai është jashtë tani. Ti sot ke një kukull. Ti kishe një top vitin e kaluar.*
- Nxënësve u jepet një varg ilustrimesh për të përdorur folje në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën ardhme sipas një shembulli të dhënë. *Ai shkruan. Ajo vizatonte një elefant. Ajo do të udhëtojë për në Londër.*
- Nxënësit shkruajnë dhe lexojnë një dialog para klasës duke përdorur shprehjet: *A mund të dal? A mund ta hap derën?*
- Nxënësve u jepet një ilustrim dhe përshkruajnë vendndodhjen e objekteve duke përdorur parafjalët e përshtatshëm të vendit: *në, mbi, nën, pranë.*
- Nxënësve u jepen karta me ilustrime. Secili nxënës duhet të marrë dy karta dhe të bëjë fjali duke përdorur lidhëzat (*dhe, edhe, por, kurse, ndërsa*). *Bananet dhe mollët janë frutat e mia të preferuara. Më pëlqejnë makaronat, por më shumë më pëlqen byreku. Më pëlqen të skijoj, ndërsa shokut tim i pëlqen të notojë.*
- Nxënësve u jepet një fletë pune me fjalë. Ata duhet të lidhin fjalët dhe të ndërtojnë fjali, duke pasur kujdes për rendin e fjalëve në fjali (vendi i kryefjalës, i kallëzuesit dhe i kundrinës). *Bukur, Milica, këndon. Milica këndon bukur; Mbledh, Berkani, luleshtrydhe. Berkani mbledh luleshtrydhe.*
- Nxënësit luajnë lojën “*Përmirësoji gabimet!*”. Ata ndahen në çifte. Secilit çift i jepet një fletë pune me rend të gabuar të fjalëve në fjali. Çdo çift i korrigjon gabimet dhe e prezanton atë që ka shkruar.
- Nxënësit lexojnë një tekst/dialog/përshkrim të shkurtër prej 5 fjalish dhe diskutojnë për fjalët e panjohura (tekstet janë në kuadër të temave të parapara me programin mësimor).
- Nxënësit dëgjojnë një njoftim/deklaratë/reklamë të shkurtër dhe diskutojnë për fjalët e panjohura. Më pas ata u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me atë që kanë dëgjuar.
- Nxënësit lexojnë një tekst dhe më pas shkruajnë pyetje (me përemrat pyetës që kanë mësuar) për atë që lexojnë. Ata pyesin dhe përgjigjen në çifte, duke ndryshuar rolet.
- Mësimdhënësi/ja jep një tekst të shkurtër me fjalë që mungojnë nga tema “*Udhëzime të shkurtra për lëvizjen në hapësirë*” dhe nxënësit dallojnë fjalët dhe shprehjet e dhëna në kontekst dhe i shkruajnë në vendin e duhur. *Do të ecësh përgjatë rrugës kryesore, do të merrësh rrugën e parë në të majtë, më pas do të shkosh deri në fund të kësaj rruge dhe do të kthesh djathtas.*

- Nxënësit sjellin ilustrime, pjesë të prera nga gazetatat ose tregojnë një foto nga telefoni i tyre për të treguar hobin ose sportin e tyre me të cilin merren. Shkruajnë 4-5 fjali të shkurtra të lidhura duke i kushtuar vëmendje përdorimit të drejtë të shkronjës së madhe, pikës, presjes, pikëpyetjes dhe pikëçuditjes. - Nëpërmjet një vizatimi, nxënësit ilustronë festimin e patronatit të shkollës së tyre. Secili nxënës përshkruan vizatimin e tij dhe tregon se si festohet Dita e Patronatit në shkollë. Nxënësit e klasave I-IX së bashku me mësimdhënësit e tyre përgatisin një shfaqje me veprimtari të ndryshme: shfaqje drame, kor dhe orkestër, recitim. - Nxënësit shkruajnë në fletë me ngjyra rregullat e sjelljes në një garë sportive. <i>Silluni në mënyrë shembullore. Mos i shqetësoni të tjerët. Mos thuaj fjalë fyese.</i> - Në një bisedë, nxënësit i tregojnë dhe i përshkruajnë monumentet në vendbanimin e tyre. (shtëpi memoriale, monumente, objekte arkeologjike, objekte fetare...) - Nxënësit shikojnë emisione për objektet fetare (kishë/xhami), pastaj ndahen në dy grupe. Të dy grupet ilustronë një objekt fetar përmes një vizatimi dhe e përshkruajnë atë me gojë.	
Tema: TRUPI YNË, SHËNDETI DHE TË USHQYERIT Gjithsej: 20 orë	
Rezultatet e të nxënit: Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë: - të kuptojë kuptimin e njësive leksikore që i ka mësuar e që lidhen me pjesët e trupit dhe të kokës, me veshjen, me ushqimin dhe me higjienën personale; - të tregojë pjesët e trupit dhe të kokës, veshmbathjet, ushqimet dhe produktet e higjienës personale; - të zhvillojë bisedë dhe dialogë të shkurtër lidhur me pjesët e trupit dhe të kokës, me veshjen, me ushqimin dhe me higjienën personale duke përdorur fjalët e duhura, emrat dhe mbiemrat e duhur, në gjininë dhe në numrin përkatës; - të përdorë drejtë renditjen e fjalëve në fjali, duke përshtatur kryefjalën, kallëzuesin dhe kundrinën në fjali dhe t'u përgjigjet saktë pyetjeve; - të lexojë, të shkruaj dhe të kuptojë fjali dhe shprehje që kanë të bëjnë me pjesët e trupit dhe të kokës, me veshjet, me ushqimin dhe me higjienën personale.	
Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet për vlerësim:
a) Modelet e komunikimit Emërtimi i pjesëve të kokës dhe të trupit <i>Kjo është koka, hunda, goja</i> <i>Ky është barku, gishti</i>	- Njih dhe emërton pjesë të kokës dhe të trupit. - Tregon veshmbathjet. - Përshkruan me fjali të thjeshta se si është veshur dikush

<i>Këto janë flokët, veshët, sytë, krahët, këmbët, Ajo ka flokë të gjata bjonde.</i> Veshmbathje <i>Unë kam veshur: xhinse, fustan, bluzë, kanatiere, këmishë, xhaketë, pallto; tuta, atlete, këpucë, pantofla, çizme</i> <i>Ata nuk kanë veshur pantallona të gjelbra</i> Shëndeti, ndjenjat dhe higjiena <i>Si je? Jam mirë. Jam i sëmurë.</i> <i>Kam nevojë për ilaçe nga barnatorja. Jam i lumtur, jam i trishtuar. Me çfarë i lani duart? I laj duart me sapun dhe ujë. Ky sapun është i mirë</i> Ushqimi - ushqimi i shëndetshëm, pijet, vaktet, enët <i>Llojet e ushqimeve: perime, fruta, mish, produkte të qumështit</i> <i>Çfarë ha për mëngjes?</i> <i>A ha makarona?</i> <i>Ata nuk duan pica me kërpudha.</i> <i>Ata duan ajvar.</i> <i>Ushqimi i shëndetshëm është:...</i> <i>Ushqimi jo i shëndetshëm është:...</i> <i>Dua të pi çaj/lëng/ujë</i> <i>Ky/kjo është pirun, lugë, thikë, filxhan, pjatë</i> Aktivitete të zakonshme ditore, argëtim, rekreacion <i>Çfarë bën në mëngjes?</i> <i>A zgjohesh herët?</i> <i>Çfarë lloj muzike dëgjon?</i> <i>Cili është filmi yt i preferuar?</i> <i>Kur luan basketboll?</i>	- Krijon pyetje, përgjigje dhe fjali për shëndetin. - Përdor shprehje për të treguar se si ndihet vetë dhe si ndihen të tjerët. - Tregon produktet higjienike që përdor çdo ditë. - Tregon llojet e ushqimeve, pijeve, vakteve dhe enëve. - Shpjegon se çfarë lloje ushqimesh i pëlqejnë, duke përdorur drejt parafjalët <i>me, pa, nga</i> dhe <i>prej</i> duke ia përshatur mbiemrin emrit në kategoritë gramatikore (picë me kërpudha; sanduiç pa djathë; lëng portokalli; qumësht i ngrohtë; bonbone shumëngjyrëshe). - Tregon llojet e ushqimeve të preferuara të njerëzve të rrethit të ngushtë. - Ndërton fjali të shkurtra për të treguar se çfarë bën zakonisht gjatë kohëve të caktuara të ditës. - Tregon aktivitetet për argëtim dhe rekreacion.
b) Leksiku	Tregon pjesët e kokës dhe të trupit të njeriut dhe i përshkruan ato.

Trupi ynë, shëndeti, ushqimi • Emrat: koka dhe pjesët e trupit: <i>koka, flokët, veshët, sytë, dhëmbët, goja, gishtat, pëllëmbët, shpatullat, krahët, gjoksi, barku, ijet, gjuri, shputat, gishtat.</i> Veshjet: <i>pantallona, fustan, këmbishë, bluzë, kanatiere, fanellë, triko, pallto, xhaketë, kapele, doreza, shall, atlete, këpucë</i> Pajisjet e higjienës personale: <i>krehër, furçë dhëmbësh, pastë, sapun, peshqir, pasqyrë, sfungjer, shampoo</i> Ushqime: perime (<i>lakër, marule, spinaq, specë, qepë, patate...</i>) fruta (<i>mollë, banane, portokall, limon, dardha, kumbulla...</i>), bulmeti (<i>qumësht, kos, djathë, dhallë, ajkë, gjizë, kaçkavall...</i>), mish. Pije të ngrohta dhe të ftohta: <i>ujë, çaj, lëng...</i> • Mbiemrat: <i>i madh, i vogël, i gjelbër, i kuq, i gjerë, i ngushtë, i lumtur, i trishtuar, i sëmurë.</i> • Foljet: <i>vrapi, luaj, vesh, përgatit, gatua, pi, ha, blej</i> Foljet në diatezën vetvetore (<i>lahem, krihem, vishem</i>) dhe mesore (<i>hidhem, kapem, kthehem, mbahem</i>) • Parafjalët: <i>me, pa, nga</i> • Fjalët pyetëse: <i>a, çfarë, kush, ku, kur, sa, pse, si</i>	• Numëron veshmbathjet, duke treguar se kur i vesh dhe i mbath ato. • Emërton dhe numëron produktet e higjienës personale. • Përdor leksikun e duhur për të shprehur se si ndihet lidhur me shëndetin dhe me ndjenjat. • Emërton dhe tregon lloje të ndryshme ushqimesh, përzgjedh produktet që janë ushqim i shëndetshëm • Tregon produktet e higjienës personale. • Krijon thënie të shkurtra me njësitë leksikore që ka mësuar duke përdorur pjesë të ndryshme të ligjëratës në kategorinë përkatëse: folje, emra, mbiemra dhe përemra.
c) Strukturat gramatikore • Llojet e fjalive sipas llojit të kumtimit (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore dhe thirrmore) • Kryefjala – frymori/sendi që kryen veprimin (<i>Emre vrapon.</i>) bartës i një tipari (<i>Emina është e mirë.</i>) ai që pëson veprimin (<i>Jelena gëzohet.</i>)	• Tregon dhe jep shembuj të fjalive sipas llojit të kumtimit me intonacion përkatës. • Identifikon frymorin/sendin që kryen veprimin përmes pyetjeve me fjalën pyetëse <i>kush, cili, cila, cilët...?</i>

- Folja në funksion të kallëzuesit në fjali (<i>shoh, pashë, do të shoh</i>) - Kundrina e drejtë (<i>Ai lexon libër; Ai e lexon librin</i>) - Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë (kryefjala – kallëzuesi – kundrina) - Fjalitë pohore dhe mohore (<i>Maria flen, kurse Marko nuk flen</i>) - Fjali pyetëse me fjalët: <i>a; çfarë, kush; ku, kur, sa, pse, si</i> - Përdorimi i parafjalëve <i>me, pa, nga, prej</i> - Përdorimi i ndajfoljeve pranë foljeve (<i>kur?; ku?; sa? sot, dje; lart, atje; shumë, pak</i>)	- Njih kryefjalën në fjali subjekt që kryen veprimin, si bartës të tiparit dhe si subjekt që pëson veprimin. - Identifikon veprimin në fjali të shprehur me një folje në kohën e tashme, në të pakryerën dhe/ose në të ardhmen. - Ndërton fjali të shkurtra që si gjymtyrë fjalie kanë kundrinë të drejtë (pa e përkufizuar kundrinën si gjymtyrë të domosdoshme të fjalisë). - Identifikon rendin e drejtë dhe jo të drejtë të fjalëve në një fjali. - Ndërton fjali të shkurtra pohore dhe mohore. - Parashtron pyetje me fjalë pyetëse dhe jep përgjigje adekuate. - Përdor drejt parafjalët <i>me, pa, nga, prej</i> në fjali të shkurtra. - Ndërton fjali duke përdorur drejt ndajfoljet (<i>kur?; ku?; sa? sot, dje; lart, atje; shumë, pak</i>).
ç) Të lexuarit me të kuptuar dhe të dëgjuarit me të kuptuar; të shkruarit Të dëgjuarit dhe të lexuarit e teksteve të shkurtra me leksik të thjeshtë, me fjali të thjeshta dhe me fjali të përbëra jo aq komplekse Të shkruarit duke respektuar rregullat drejtshkrimore për përdorimin e shkronjës së madhe, pikës, pikëpyetjes, pikëçuditjes.	- Dëgjon dhe kupton përmbajtje të shkurtra me leksik përkatës. - I ndan fjalët e panjohura në një tekst me përmbajtje nga kjo temë. - U përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen që ka dëgjuar ose që ka lexuar (tekst, njoftim, reklamë). - Jep informacion të shkurtër dhe konkret nga një tekst që ka dëgjuar ose që ka lexuar. - Parashtron pyetje në mënyrë të pavarur për tekstin që e dëgjon ose që e lexon. - Lexon me zë duke i shqiptuar drejt tingujt, duke i theksuar drejt fjalët dhe duke e përdorur intonacionin e duhur të fjalisë. - Shkruan tekst të shkurtër duke përdorur rregullat drejtshkrimore për shkronjën e madhe, pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen.
d) Përmbajtje ndërkulturore Ushqimi si gjuhë universale e komunikimit Moda dhe mënyra e veshjes	- Emërton gatime dhe ëmbëlsira tradicionale nga kultura të ndryshme në vendin tonë. - Emërton përbërësit për përgatitjen e ushqimeve tradicionale. - Diskuton gatimet e preferuara nga kuzhinat e ndryshme duke përdorur leksikun e duhur. - Tregon elementet e veshjeve tradicionale dhe atyre moderne.

- Tregon veshjet e preferuara dhe stilin e veshjes.

Shembuj të aktiviteteve:

- *(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to).*
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Secilit i jepet nga një fletë mësimore me vizatime, ku nxënësit duhet të shënojnë dhe të përshkruajnë pjesët e trupit dhe kokës. Më pas kontrollojnë detyrat së bashku para klasës.
- Nxënësit ndahen në çifte. Çdo çift duhet të shpjegojë një aktivitet që kryhet me një pjesë të trupit. Çiftet e tjera duhet të qëllojnë se cili është aktiviteti dhe ta emërtojnë pjesën e trupit që është përdorur. Shembull, bërryli (*lakojmë krahun*), kyçi i dorës (*lëvizin dorën, kthejmë pëllëmbën, me pëllëmbë mbajmë sendet, me dorë shkruajmë*), krahu (*përqafojmë, kryejmë punë të ndryshme...*)
- Nxënësve u jepen ilustrime, mundet edhe fotografi revistash, tregojnë dhe përshkruajnë çfarë rroba dhe këpucë kanë veshur personat e paraqitur në ilustrim.
- Nxënësit simulojnë dialogë: *Si je? Mirë jam. Ti si je? Unë jam i sëmure. Më dhemb fyti. / Si je? Sot jam i mërzhitur, shoku im u nis për në Gjermani.*
- Nxënësit të ndarë në grupe luajnë lojën “*Trupi ynë flet*”. Kanë për detyrë që me ndihmën e komunikimit joverbal, shprehjeve të fytyrës dhe gjeesteve të shprehin emocionet e tyre. Secili nga grupi tregon një emocion, nxënësit shkruajnë një fjali të shkurtër duke përdorur foljen *jam* në kohën e tashme, një përemër vector dhe një mbiemër: *Unë jam ... Ti je ... (i/e lumtur, i/e mërzhitur, i/e frikësuar, i/e hutuar, i/e zhytur në mendime*
- Nxënësve u jepen fjali të cilat duhet t’i plotësojnë me një fjalë që është pjesë e fjalorit të higjienës personale. *Duart i laj me ----- Floket i kreh me ----- etj.*
- Nxënësve u jepet një ilustrim me një tavolinë të shtruar dhe pranë secilit send, ene apo ushqimi është vendosur një numër. Poshtë ilustrimit ka vija boshe ku nxënësit do të shkruajnë fjalët që emërtojnë sendin/enën/ushqimin sipas numrit që ka.
- Nxënësit sjellin materiale: foto të vogla të familjarëve, foto nga revista, ngjyra, një fletë blloku dhe bëjnë një kolazh me portrete të vizatuar të familjes dhe poshtë tyre pjata në të cilat do të vizatohen ose ngjiten ushqimet e preferuara të familjarëve. Nën to nxënësit shkruajnë fjali të shkurtra: *Vëllait tim i pëlqen sanduichi me djathë. Mamit i pëlqejnë makaronat me salcë etj.*
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me ilustrime, në të cilën është paraqitur një djalë/vajzë që zgjohet, që shkon në shkollë, që shkruan, që luan ndonjë sport, që shoqërohet në shtëpi, që shtrihet në shtrat. Nxënësit shkruajnë nga një fjali, me të cilën tregojnë se cilat janë aktivitetet e tyre të përditshme dhe kur i bëjnë ato.
- Nxënësit vizatojnë një vizatim lidhur me aktivitetin e tyre të preferuar për argëtim/rekreacion dhe shkruajnë fjali të shkurtra për të: *Më pëlqen shumë të luaj basketboll. Unë luaj çdo ditë. Unë luaj me shokët e mi në këndin e lojrave.*
- Nxënësit punojnë në çifte, përshkruajnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin sipas ilustrimeve të dhëna: *Ajo ka flokë të gjatë. Ai ka krahë të gjatë të holla. Ajo ka sy të gjelbër.*

- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me veshje të ndryshme, nën të cilën duhet të shkruajnë si quhet ajo veshje ose lloji i këpucëve dhe më pas secili prej tyre atë ta lidhë me një nga stinët e vitit të shkruar në fund të fletës (stinën kur vishet).
- Nxënësve u jepen fletë me fjali të papërfunduara, në të cilat ka hapësirë që duhet të plotësohet me fjalë, të cilat tregojnë enët që përdorim kur hamë. Nga fjalitë e dhëna nxënësit simulojnë dialogje para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit shikojnë ilustrime dhe thonë fjali me të cilat tregojnë se si ndihet personazhi në ilustrim.
- Nxënësit diskutojnë në temën *Ushqimi i shëndetshëm*, tregojnë ushqimet e shëndetshme dhe më pas numërojnë ushqimet e tyre të preferuara, duke përcaktuar vetë nëse ushqimi i tyre i preferuar është i shëndetshëm.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe luajnë asociacione në temën *Produktet e higjienës personale*. Për çdo fjalë të qëlluar, çifti mendon një fjali të shkurtër të cilën e shkruan në tabelë.
- Nxënësit shkruajnë disa fjali (4-5), për një temë që e zgjedhin. *Esini pëlqen çajin e nxehtë, kurse Sarës i pëlqen çaji i ftohtë. Artani ha vetëm perime.*
- Nxënësve u jepen një grup fjalish: dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore dhe thirrmore. Të gjitha fjalitë janë në çifte: pyetëse dhe dëftore, dëftore dhe thirrmore, pyetëse dhe nxitëse etj. Nxënësit i lexojnë fjalitë duke përdorur intonacionin e duhur. Arrijnë në përfundimin se intonacioni u ndihmon për të përcaktuar llojin e fjalisë, kurse në të shkruar llojin e fjalisë e përcaktojnë nëpërmjet të shenjave të pikësimit.
- Nxënësit njohin frymori/sendi që kryen veprimin (*Emili vrapon.*), që është bartës i një tipi (*Emina është e mirë.*) apo që pëson veprimin (*Jelena gëzohet.*). Së bashku arrijnë në përfundimin se fjala pyetëse *kush/cili* i ndihmon të përcaktojnë atë që kryen veprimin, atë që është bartës i një tipi apo at[që pëson veprimin dhe se kjo fjalë qëndron zakonisht në fillim të fjalisë.
- Nxënësit punojnë në çifte. Secili çift merr një fletë pune me fjali. Detyra e nxënësve është të lexojnë fjalitë dhe të identifikojnë veprimet e përfaqësuara nga format e foljeve vetore për kohën e tashme, të pakryerën dhe/ose të ardhmen. Disa nxënës shkruajnë përgjigjet në tabelë dhe japin shpjegime për veprimin e identifikuar në fjali.
- Nxënësit punojnë në grupe. Secilit grup i jepet një ilustrim. Detyra e grupeve është që, sipas përmbajtjes së dhënë të ilustrimit, të hartojnë pesë fjali të shkurtra, në të cilat do të ketë një kundrinë si gjymtyrë fjalie, p.sh.: *Arta ha bakllava. Denisi ha fli. Vesna bën çaj. Bashkimi lexon libër etj.* Fjalitë lexohen para gjithë klasës.
- Nxënësve të ndarë në grupe, u jepen fletë pune në të cilat janë shkruar disa fjali të shkurtra me rend të gabuar të fjalëve. Secili grup duhet t'i shkruajë fjalitë me rend të drejtë të fjalëve dhe t'i paraqesë ato para grupeve të tjera. Në fund, mësimdhënësi/ja paraqet redin e drejtë të fjalëve në tabelën e mençur ose në një tabelë të thjeshtë dhe nxit një diskutim me nxënësit për përgjigjet e pasakta eventuale.
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Secilit i jepet një fletë mësimore me ilustrime që tregojnë veprime që mund të përdoren për të kumtuar diçka, për të pyetur për diçka, për të shprehur një dëshirë, ndonjë nevojë, për të dhënë një urdhër. Sipas ilustrimeve, nxënësit shkruajnë fjali të shkurtra pohore. Në vazhdim, të gjitha ato veprime që përfaqësojnë fjalitë duhet të mohohen, pra fjalitë pohore në këtë mënyrë bëhen mohore. Në fund të gjithë bashkë i lexojnë fjalitë e tyre, të cilët kontrollohen para gjithë klasës.
- Nxënësit ndahen në çifte. Secili çift duhet të shpjegojë një veprim që i referohet një pjese të trupit. Njëri nxënës parashtrohet pyetje me fjalë pyetëse dhe nxënësi tjetër jep përgjigjen e duhur pyetjes (*Çfarë funksioni kanë sytë? etj.*) Shkruhen fjalitë në tabelë dhe diskutohet për përdorimin dhe rolin e fjalës pyetëse.

- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Secilit nxënës i jepet një fletë pune, në të cilën shkruhen fjali ku mungojnë parafjalët. Çdo fjali mbështetet nga një ilustrim. Detyra e nxënësve është të përdorin parafjalën e duhur varësisht nga kuptimi i fjalive. Mësimdhënësi/ja paraqet në tabelë përgjigjet e sakta dhe nxit diskutim me nxënësit për funksionin e parafjalëve: *me, pa, nga, prej*.
- Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një fletë pune në të cilën janë shkruar disa ndajfolje si p.sh. të kohës, të vendit dhe të sasisë (*drejt, majtas, djathtas, andej, këndeje, më këtej, më andej, gjatë, së shpejti, pastaj, më në fund, shumë, pak, dje, sot, nesër, vonë, herët*, etj.). Secili grup tërheq një fletë me disa ndajfolje në të cilat janë shkruar tema të ndryshme (p.sh., *Si të arrij në...; Shkojmë në një ekskursion; Do të festojmë Bajramin/Pashkët/Shën Gjergjin*) dhe u jepet detyra të krijojnë 5 fjali për temën që e kanë tërhequr, duke përdorur sa më shumë nga ndajfoljet e dhëna në fletën e punës. Gjatë diskutimit konstatojnë se cilat ndajfolje janë përdorur drejt në fjalitë e paraqitura nga nxënësit.
- Mësimdhënësi/ja lexon një tekst të shkurtër/njoftim/reklamë në lidhje me shfrytëzimin e kohës së lirë/stërvitjen e një sporti të caktuar/përdorimin e mjeteve të ndryshme të transportit etj., të përgatitur që më parë. Më pas nxënësit u përgjigjen pyetjeve të tipit e saktë/ e pasaktë ose pyetje të hapura që i referohen leksikut përkatës. Në fund, secili nxënës në mënyrë të pavarur jep informacione të shkurtra (1 deri në 2 fjali) në lidhje me përmbajtjen e lexuar. Disa nxënës vullnetarisht prezantojnë punën e tyre.
- Nxënësit punojnë në çifte, luajnë rolin mësues – nxënës. Njëri nxënës lexon, kurse nxënësi tjetër në rolin e mësuesit bën dy ose tri pyetje për atë që është lexuar. Më pas ndërrojnë rolet.
- Nxënësit luajnë lojën “*Radio/TV speaker*”. Mësimdhënësi/ja jep informatë kthyesë për leximin e nxënësve.
- Nxënësit në grupe përgatisin listat e produkteve që përdoren gjatë kremtimit të një feste të caktuar. Secili grup prezanton listën përkatëse duke i shkruar produktet në tabelë. Së bashku me mësuesin diskutojnë për saktësinë e asaj që është shkruar.
- Nxënësit tërheqin fleta në të cilat janë shkruar bashkësitë etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bazë të të cilave grupohen në grupe. Secili grup hulumton mbi ushqimin tradicional të bashkësisë etnike që i ka rënë dhe përgatit një tekst të shkurtër të shoqëruar me ilustrime që do të vendosen në sllajd të një prezantimi multimedial. Më pas mësuesi i bashkon sllajdet në një prezantim të përbashkët i cili do të shfaqet para nxënësve në klasë. Në bazë të prezantimit zhvillohet diskutim përmes të cilit konstatohen ngjashmëritë në ushqimin tradicional të kulturave të ndryshme në vendin tonë dhe përbërësit të cilët përdoren për përgatitje. Gjithashtu grupet inkurajohen të përdorin leksikun e duhur kur japin mendimet e tyre për ushqimet e preferuara.
- Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secili grup ka para vetes disa gjëra të rëndësishme për veshjen tradicionale dhe moderne: veshjet tradicionale - pjesë e një kostum kombëtar (këmisha, opingat, pantallonat, tirqit, plisi, shamitë, dimitë, fesi etj.), veshje moderne (atletet, xhinset, xhupi etj.). Detyra e secilit grup është të zgjedhë artikujt dhe të shkruajë se cili artikull cilit prej grupeve të dhëna i përket – veshjeve tradicionale, veshjeve moderne, veshjeve të preferuara, veshjeve folklorike. Secili grup i shkruan veshjet e përzgjedhura në një fletë pune. Hapet diskutim për mënyrën e veshjes.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet inkuadrimin të të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpaket të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shitesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave /përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlihin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'u mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/ja ndjek përvojat, njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve, përcjell vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënësi. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe u japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim mësimdhënësi/ja përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet e dhëna me gojë pyetjeve të mësimdhënësit/es ose të nxënësve të tjerë;
- përgjigjet e dhëna me gojë dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- punimet e projekteve;
- krijimin e posterave;

- detyrat kontrolluese;
- testet e njohurive;
- punimet/realizimet praktike (të shkruarit/krijimin e teksteve sipas kërkesave të ndryshme, ekspozitat, ilustrimet, prezantimet etj.);

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr notë sumative (përmbledhëse) të standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me vlerësimin e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2026/2027
Institucioni/bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit Биро за развој на образованието
Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe (lëndë me zgjedhje)</i> për klasën VIII. Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19, 229/20, 3/25 и 74/25) министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик (изборен предмет)</i> за VIII одделение.	бр. 12-12084/10 12.9.2025 година Министерка за образование и наука, проф. д-р Весна Јаневска, с.р.